



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 852 Prot.

Tiranë, më 19.062017

VENDIM Nr. 121, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor. në kuadër të *projektit "Ndërtimi Stacionit të ri VALBONA 1560"*- subjekti "Telecom Albania" sh.a.. realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi Stacionit të ri VALBONA 1560"*- subjekti "Telecom Albania" sh.a.. realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Shkodër dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUBINA ZOTO